



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

**KOMUNA E ISTOGUT** në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

**KONTRAKTORI "MENTI" Shpk Komuna e Istogut**, të cilën e përfaqëson z. Islam Shoshi, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810298556 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

### TITULLI I KONTRATËS:

**NDËRTIMI I NDËRTIMI I TRIBINAVE NE STADIUMIN E FUTBOLLIT  
"DEMUSH MAVRAJ" ISTOG**

<i>Nr. I prokurimit</i>	633-20-5372- 5-3-5/ C 408
<i>Nr. I brendshëm</i>	633 / 020 / 087 / 521

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

**NDËRTIMI I NDËRTIMI I TRIBINAVE NE STADIUMIN E FUTBOLLIT  
"DEMUSH MAVRAJ" ISTOG**

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I TRIBINAVE NË STADIUMIN E FUTBOLLIT "DEMUSH MAVRAJ" ISTOG -të është: 9.369,36 € dhe me fjalë: Nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro -36/100 €**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës:**

#### **3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:**

*Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4. Afati i përmbushjës së kontratës:**

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 10 ditësh, nga data e nënshkrimit të së njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 21.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

### **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.





5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim,

miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për: Autoritetin Kontraktues:  
KOMUNA E ISTOGUT**

**Për: Kontraktuesin:  
"MENTI" Shpk**

<b>Emri:</b>	<b>Gëzim Ademaj</b>	<b>Emri:</b>	<b>Islam Shoshi</b>
<b>Pozita:</b>	<b>U.D. Menaxheri-t I Prokurimit</b>	<b>Pozita:</b>	<b>D r e j t o r</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<b>19. 11. 2020</b>	<b>Data:</b>	<b>19. 11. 2020</b>
<b>Vu la</b>		<b>Vu la</b>	

Numri i Prokurimit: 633/20/087/535– Titulli : NDERTIMI I TRIBINAVE NE STADIUMIN E FUTBOLLIT DEMUSH MAVRAJ-ISTOG -pune shtese

		kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.
		Evidenca 3: Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar nga noteri).
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.2	Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
		Evidenca 1: Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
		Kërkesa 2: Regjistrimi i numrit fiskal ne ATK.
		Evidenca 2: Regjistrimi i numrit fiskal ne ATK.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1	N/A
	8.2	N/A
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	N/A
	9.2	N/A
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	<p>a. <b>një deklaratë e qartë</b> ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës</p> <p>b. <b>një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët</b>, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;</p> <p>c. <b>një deklaratë të nënshkruar</b> nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe</p> <p>d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të <b>jenë të përshtatshëm</b> dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.</p> <p>e. Secili anëtar i grupit te Operatoreve ekonomik duhet te regjistrohet ne platformën elektronike.</p>
Nënkontraktimet	12.1	<p>a) <b>një deklaratë</b> ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe</p> <p>b) Të gjithë nënkontraktorët do të <b>jenë të përshtatshëm</b> dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.</p>
Siguria e tenderit	13.1	Nuk kërkohet sigurim i tenderit.
Siguria e	14.1	Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni, para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit.

Numri i Prokurimit: 633/20/087/535– Titulli: : NDERTIMI I TRIBINAVE NE STADIUMIN E FUTBOLLIT DEMUSH MAVRAJ-ISTOG -pune shtese

ekzekutimit		
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej <b>2 muaj</b>
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	<b>11.11.2020</b>
Periudha vlefshmërisë së tenderit	21.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë 60 ditë.
Vulosja dhe Shënimi i Tenderëve	22.1	Permes e-prokurimit
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	23.1	Afati i fundit për dorëzim është je <b>13.11.2020 15:30:00</b> Vendi: <b>Zyra e Prokurimit - Komuna e Istogut.</b>
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do te bëhet me <b>13.11.2020 15:30:00</b> Vendi: <b>Zyra e Prokurimit - Komuna e Istogut.</b>
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me <b>Çmimin më te ulët</b>
Ankesat	31.3	<b>Kerkesa duhet te dorezohet permes platformes elektronike te Prokurimit</b>

Numri i Prokurimit: 633/20/087/535– Titulli : NDERTIMI I TRIBINAVE NE STADIUMIN E FUTBOLLIT DEMUSH MAVRAJ-ISTOG -pune shtese

**PJESA III E KONTRATES**

**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>[shëno emrin, adresen e menaxherit të Projektit]</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <i>[është 10% i vlerës së kontratës.</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	n/a
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.  a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.  Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**NDËRTIMI I TRIBINAVE PERËNDIMORE STADIUMI "DEMUSH MAVRAJ" - ISTOG**

**PUNIME TE PA-PARAPARA**

A.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi Euro	Total Euro
<b>3</b>	<b>Punët e betonit dhe muratimit</b>				
	Betonit duhet të jetë natyral (pa trajtim të mëvonshëm) me additive për mospërskueshmëri të ujit, mbrojtje nga acari dhe rezistente ndaj abrazionit, tek shkelset (shkallët) sipërfaqet duhet të jenë mesatarisht të vrazhda (R-12).				
3.3	Betonimi i trarëve dhe brezave /shiko projektin/ nga betoni i armuar C 30/37 , me pahi dhe skele të nevojshme. Llogarimi në m <sup>3</sup> të betonit të vendosur.	m <sup>3</sup>	17,50	75,00 €	1 312,50 €
3.4	Betonimi i pllakës-shkalleve të tribinave, në një proces (shkelëset dhe balloret) sipas projektit, nga betoni i armuar C 30/37, me pahi dhe skele të nevojshme. Llogaria të bëhet për m <sup>3</sup> te betonit të vendosur.	m <sup>3</sup>	48,50	75,00 €	3 637,50 €
<b>Totali 3</b>					<b>4 950,00 €</b>
<b>4</b>	<b>Punët e armimit</b>				
4.1	Punimi dhe montimi i armaturës sipas llogarisë statike nga profilet dhe kualiteti S 500 H për të gjitha pozicionet duke ju referuar skemave statike. Llogaria në kg të armaturës së vendosur në punë.	kg	6 696,00	0,66 €	4 419,36 €
<b>Totali 4</b>					<b>4 419,36 €</b>
<b>REKAPITULIMI</b>					
3	Punët e betonit dhe muratimit				4 950,00 €
4	Punët e armimit				4 419,36 €
<b>TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT</b>					<b>9 369,36</b>



*[Handwritten signature]*